



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **02.03.2025** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal *“Arrest në burg”*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personave nën hetim **Erdit Hazizaj, Shkëlzen Ruska dhe Ervis Alisinanaj**”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare Etleva Deda, bazuar në nenet 228, 229, 230, 232, 238, 244, 246 e 248 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **28**, datë **03.03.2025** vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues *“Arrest në burg”*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e caktuar me Vendimin nr. 17, datë 28.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj personit nën hetim **Erdit Hazizaj**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i lëndëve narkotike”*, kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atij të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a paragrafi i parë dhe 28/4 të Kodit Penal; *“Kultivimi i bimëve narkotike”*, kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atij të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 284 paragrafi i parë dhe 28/4 të Kodit Penal; *“Grupi i strukturuar kriminal”*, kryer në formën e pjesëmarrjes, parashikuar nga neni 333/a paragrafi i dytë i Kodit Penal; *“Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal dhe *“Shpërdorimi i detyrës”*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
3. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues *“Arrest në burg”*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e caktuar me Vendimin nr. 17, datë 28.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj personit nën hetim **Shkëlzen Ruska**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale *“Kultivimi i bimëve narkotike”*, kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atij të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 284 paragrafi i parë dhe 28/4 të Kodit Penal; *“Grupi i strukturuar kriminal”*, kryer në formën e pjesëmarrjes, parashikuar nga neni 333/a

- paragrafi i dytë i Kodit Penal; *“Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal dhe *“Shpërdorimi i detyrës”*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
4. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues *“Arrest në burg”*, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e caktuar me Vendimin nr. 17, datë 28.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj personit nën hetim **Ervis Alisinanaj**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale *“Kultivimi i bimëve narkotike”*, kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atij të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 284 paragrafi i parë dhe 28/4 të Kodit Penal, *“Grupi i strukturuar kriminal”*, kryer në formën e pjesëmarrjes, parashikuar nga neni 333/a paragrafi i dytë i Kodit Penal; *“Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, parashikuar nga neni 334 pika 1 i Kodit Penal; *“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”*, parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i tretë i Kodit Penal dhe *“Shpërdorimi i detyrës”*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
 5. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për ekzekutimin e këtij vendimi.
 6. Ndalohet publikimi i këtij Vendimi, në referim të nenit 103 të Kodit të Procedurës Penale.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, brënda afatit ligjor.

Tiranë, më datë 03.03.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar